



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**V E N D I M**

**K.P.P676/2018**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.10.2018 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Modifikimi i dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr. REF-79689-07-18-2018 me objekt: “*Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit Memaliaj, rrjet shpërndarës*” me fond limit 83,333,021 lekë pa tvsh, e parashikuar për tu zhvilluar në datën 20.08.2018, nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Tepelenë.

**Ankimues:**

“B-93” shpk  
Lagjia “8 Shkurti”, Rruga “Andon Doro”, Fier

**Autoriteti Kontraktor:**

Ujësjellës Kanalizime Tepelenë sha  
Bashkia Tepelene Kati II

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.914 datë 29.12.2014 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” .

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## V ë r e n:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik, konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 19.07.2018 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr. REF-79689-07-18-2018 me objekt: “*Rikonstrukcion i rrjetit të ujësjellësit Memaliaj, rrjet shpërndarës*” me fond limit 83,333,021 lekë pa tvsh, e parashikuar për tu zhvilluar në datën 20.08.2018, nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Tepelenë.

II.2. Në datën 23.07.2018 operatori ekonomik “B-93” shpk, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit me argumentat si më poshtë:

- *Së pari: Në pikën 2.2/3 Për kapacitetin teknik pika 2 kriteret e vecanta të kualifikimit të DST është përcaktuar:*

*Liçensa profesionale e shoqërisë lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:*

- *N.P-1-C*
- *N.P-4- A*

- N.P-5- B
- N.P-7- C
- N.P-12-A
- N.S-8- B
- N.S-9- C
- N.S-10- A
- N.S-16- A
- N.S-18- A
- N.S-20- A

*Kriteri i vendosur nga Njësia e Prokurimit për kategorinë NS 9-C Punime strukturore speciale tejkalon natyrën dhe vlerën e kontratës objekt prokurimi. Sipas kategorizimit të punimeve të ndërtimit për kategorinë NS9-C duhet që vlera e punimeve që klasifikohen në strukturore speciale të jetë 51-100 milion lekë. Vlera e gjithë objektit është 83,333,021 lekë pra i gjithë objekti është kategoria C. Duke shqyrtuar preventivin e punimeve zërat e tij konsistojnë në punime të zakonshme betoni dhe nuk ka zëra që të legjitimopjnë kategorinë C që është vendosur. Kjo kategori licence nuk është në përpjestim dhe e lidhur me aftësitë zbtuese natyrën dhe vlerën e kontratës për këtë arsye kërkojmë modifikimin e kësaj kategorie të licencës. Është NS-9C të bëhet NS-9A.*

- *Së dyti: Në pikën 2.2/3 Për kapacitetin teknik pika 4 kriteret e vecanta të kualifikimit, të DST-ve është përcaktuar:*
- *Një punësim mesatar i të paktën 150 (njqindepesdhjet) personave, për periudhën Janar 2017 – Maj 2018 të vërtetuar me;*
- *a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; per periudhen Janar 2017 - Maj 2018.*
- *b. List pagesat e punonjesve sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen Janar 2017 - Maj 2018shoqëruar me formularet e deklarimit te pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetesore.*

*Në DT punimet për këtë objekt janë parashikuar për një periudhë 4 muaj dhe bazuar në manualin e cmimeve të ndërtimit në fuqi Vendim i KM Nr.629 datë 15.07.2015 Për miratimin e manualeve teknike të cmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre kemi bërë zbërthimin dhe analizimin e gjithë zërave të punimeve dhe rezulton që këto punime kryhen me një staf më të reduktuar se ai që ju keni përcaktuar për të njëjtën periudhë kohe. Numri i punonjësve i kërkuar prej jush (150 punonjës) i tejkalon standartet e vendosura nga KM me disa herë. Kërkojmë të ulet numri i punonjësve nga 150 në 80.*

- *Së treti: Ne pikën 2.2.3 Për Kapacitetin teknik pika 9 Kriteret e Vecanta të Kualifikimit të DST është përcaktuar:*
- *9.Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë*
- *Çertifikatë ISO 9001-2008 (e vlefshme).*

- Çertifikatë ISO 14001-2004 (e vlefshme).
- Çertifikatë OHSAS 18001-2007(e vlefshme).
- Çertifikatë ISO 39001 -2012 (e vlefshme).
- Çertifikatë PASS 99-2012 (e vlefshme).
- Çertifikatë ISO 50001 -2011 (e vlefshme).
- Çertifikatë ISO 27001:2013 (e vlefshme)
- Çertifikatë ISO 3834-2:2006 (e vlefshme)
- Çertifikatë SA 8000:2014 (e vlefshme)
- Çertifikatë SA 28000:2007 (e vlefshme)
- Çertifikatë DS CEN/TR 15128:2005 (e vlefshme)
- Certifikatë DS CEN/TR 1452-1:2009(e vlefshme)

(Ne rast bashkimi operatorësh ekonomik certifikatat e mesiperme duhet te plotesohen nga te gjithë antaret sipas perqindjes se punimeve qe do te marre persiper te realizoje sipas akt marrveshjes).

Certifikata DS CEN/TR 15128:2005 (e vlefshme) është një certifikatë për “Shqyrtimin i Standarteve Europiane për riparimin e sistemeve të kanalizimeve dhe kullimit. Objekti i prokurimit janë punimet për rikonstrukcionin e rrjetit të ujësjellësit (furnizim me ujë) nuk ka punime kanalizimi (të ujrave të bardha apo të zeza) apo punime kullimi të ujrave. Kërkesa për paraqitjen e kësaj certifikate është e pambështetur teknikisht , është kufizuese për operatorët ekonomikë dhe e pabazuar në ligj.

Certifikata DS CEN/TR 1452-1:2009(e vlefshme) është për Sistemet e tubacioneve plastike për furnizimin me ujë dhe kullimin e ujrave të zeza mbi tokë nën presion. Në lidhje me vendosjen e kësaj certifikate si kriter vlerësimi është e pambështetur teknikisht, kufizuese për OE dhe e pabazuar në ligj. Nëse shikojmë projektin e zbatimit do të vërejmë që tubacionet në asnjë segment të tij nuk janë mbi tokë por nën tokë. Rrjedhimisht ky kriter është abuziv pasi nuk ka lidhje me objektin e prokurimit.

Për sa më sipër kërkojmë verifikimin e standarteve të certifikatave certifikatë DS CEN/TR 15128:2005 dhe DS CEN/TR 1452-1:2009 dhe heqjen e tyre si kriter vlerësues.

- Së katërti: Në pikën 2.2/3 Për kapacitetin teknik pika 12 Kriteret e vecanta të Kualifikimit të DST është përcaktuar:

12. Operatori ekonomik duhet të kete nje kontrate me nje laborator te certifikuar me certifikate ISO 9001:2008 cilesie, certifikate ISO 14001certifikate OHSAS 18001per mjedisin per kryerjen e analizave te betoneve, dherave dhe rerave qe do te perdoren ne objekt i cili te jete i akredituar per kryerjen e analizave sipas standarteve shteterore si me poshte:

- - Përcaktimi i rezistences ndaj copezimit SSH EN 1097-2:2010 S SH EN 932-1:2004 2

- - *Beton i ngurtesuar : Mostrat e marra nga struktura – Marrja ekzaminimi dhe testimi ne shtypje <2000KN SSHEN 12504-1:2009 SSHEN 12504-1:2009 2*
- - *Metodikat e kryerjes se provave pa shkaterrim te betonit- Përcaktimi i shpejtësisë së impulsit ultrasonik ( Sshen 12504-4:2008 1*
- - *Beton i fresket ; Përberja e perzierjes se betonit / formula e mix design SSHEN 206:2013 + A 1:2016*
- - *; Percaktimi i forces ne shtypje e mostrave te testimit <2000 kN SSHEN 12390-3:2009 / AC :2011*
- - *Percaktimi i pikes se zbutjes S SH EN 1427:2015*
- - *Percaktimi i trashesise se nje shtrese bituminoze – mm S SH EN 12697 – 29 : 2006, S SH EN 12697 – 36:2006 S SH EN 12697 – 27 : 2022 2*
- - *Prova e penetrometrit SPT – S SH EN ISO 22476-3:2005/A1 : 2011 1*
- - *Hekur per punme ndertimi; Rezistenca ne terheqje – S SH EN 6892-1:2016*
- - *Dhera – Percaktimi i permbajtjes se ujit % Iso/TS 17892-1:2014*
- - *Percaktimi i peshes specifike. Metoda me piknomete ISO/TS 17892-3:2015*
- - *Mteriale rrugore – Metodikat e kryerjes se provave pa shkaterrim te shtresave rrugore . Metoda e testimit per percaktimin e deformimeve me pajisjen Falling-Ëeight-Type Impulse Load Device – >I um ASTM D 4694-2015 1*
- - *Karakteristikat e siperfaqes se rruges dhe te pistes se avionit, Metodat e proves, Matja e profilit te terthorte dhe gjatesore te ashpersise dhe devijimet ne drejtim te valezimeve gjatesore. Llogaritja e indeksit nderkombetare te rrjeshmerise se rrugesve- S SH EN 13036-6:2008 ASTM E 950/E 950M:2009 ASTM E 1926:2015 1*

*Kriteri i vendosur nga Njësia e Prokurimit për paraqitjen e një kontarte me një laborator të certifikuar me certifikatë ISO 9001:2008 cilësie, 14001: 18001 për kryerjen e analizave të betoneve, dherave dhe rërave është e ekzagjeruar duke qenë se me lidhjen e kontratës cdo kontraktor e ka detyrimin ligjor që të bëjë analiza laboratorike për punimet e kryera . Por këto analiza bëhen pasi merret paraprakisht miratimi i mbikqyrësit të punimeve për realizimin e një punimi të caktuar. Kjo kërkesë është e parakohshme dhe diskriminuese. Paraqitja e kësaj kontrate nuk ndikon drejtpërdrejt në vlerësimin e aftësisë teknike të OE pjesmarrës pasi kjo është një pikë që ezaurohet në fazën e zbatimit të punimeve.*

*Sa më sipër ky kriteri është tërësisht në kundërshtim me legjislacionin specifik të ndërtimit dhe duhet të hiqet.*

- *Së pesti: Gjithashtu edhe kërkesat:*

#### **Tuba HDPE 100**

- *Autorizimin nga prodhuesit për distributorin e autorizuar*
- *Autorizimin nga distributori për ofertuesin*
- *Çertifikatë për prodhuesin/ distributorin ISO ISO 9001 , ISO 14001 , PAS 1075 ,*
- *Standardi DIN 8074*

- *Miratimet PAS 1075 , DIN 8075 , DVGË GË 335 A2 , EN 12201*
- *Certifikatat e testimit*
- *Testet e miratimit të materialit në përputhje me PAS 1031 dhe PAS 1075*
- *Testet e sigurimit të cilësisë së materialit në përputhje me PAS 1075*
- *Testet e miratimit të tubave në përputhje me PAS 1075*
- *Testet e kontrollit të cilësisë së tubave në përputhje me PAS 1075*

#### *Kërkesat*

*Shënimi i tubave me shenja lazer duke përfshirë gjurmimin e tipit barkod të tipit 128-C në përputhje me ISO 12176-4 të shtypur direkt në tub.*

#### ***Pajisje elektrofuzioni për nyje e tubave PE 100***

- *Autorizimin nga prodhuesit për distributorin e autorizuar*
- *Autorizimin nga distributori për ofertuesin*
- *Çertifikatë për prodhuesin/ distributorin ISO 9001 , ISO 14001*
- *Miratimet DVGË , EN 12201*
- *Kërkesat*

*Materiali: PE 100*

*Vlerësimi i presionit: SDR 11*

*Kompensimi i temperaturës (koha e fuzionit përshtatet automatikisht me temperaturën e ambientit)*

*Barkodi për procesin e shkrirjes automatike*

#### ***Saracinesca sipas dimensioneve te preventivit***

- *Autorizimin nga prodhuesit për distributorin e autorizuar*
- *Autorizimin nga distributori për ofertuesin*
- *Çertifikatë për prodhuesin/ distributorin ISO 9001*
- *Standardi EN 1074 (1-2) , ISO 5996*
- *Certifikuar për ujë të pijshëm për DVGË*
- *Kërkesat*
- *Përmasat ballë për ballë në EN 558-1: 2017 seri F14 (DIN 3202, F4)*
- *Dimensionet e fllanxhave dhe shpimet e EN 1092-2*
- *Trupi dhe mbulesa e hekurit EN 1563*
- *Epoxy veshura brenda dhe jashtë DIN 30677-2 dhe GSK "mbrojtje korrozioni të rëndë" (trashësia e veshjes > 250µm)*
- *Projektuar për temperatura të shërbimit nga 0 ° C (duke përjashtuar acar) deri në 40 °*

**C**

#### ***Ajrues***

- *Autorizimin nga prodhuesit për distributorin e autorizuar*

- Autorizimin nga distributori për ofertuesin
- Çertifikatë për prodhuesin/ distributorin ISO ISO 9001
- Standardi EN 1074-4
- Certifikuar për ujë të pijshëm për DVGÜ
- Kërkesat
  - Valvul automatik me ajër të dyfishtë
  - Fllanxha EN1092-2
  - Rondele gome EPDM
  - Shkarkimi i vëllimeve të mëdha të ajrit gjatë fillimit dhe zbrazjes së tubacioneve
  - Shkarkimi i vëllimeve të vogla të ajrit ndërsa tubacionet janë nën presion
  - Veshje epoxy të brendshme dhe të jashtme

#### **Mates uji sipas dimensioneve te preventivit**

- Autorizimin nga prodhuesit për distributorin e autorizuar
- Autorizimin nga distributori për ofertuesin
- Çertifikatë për prodhuesin/ distributorin ISO ISO 9001 ISO 14001
- Standardi EN 1074-4, ISO 4064 , EN 14154 OIML R49
- Certifikuar për ujë të pijshëm (p.sh: ACS ose ERAS) Miratimi i MID

Duhet të hiqen pasi kërkesat për paraqitjen e pajisjeve dhe materialeve janë të pavend. Listën dhe cilësinë e materialeve që vendosen në vepër nuk mund ta testojë KVO. Referuar Udhëzimit Nr.3 datë 15.01.2001 “Për Mbikqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit në pikën 9 të tij shprehet qartazi se: 9. Materialet që vijnë në kantier duhet të jenë në përputhje me kërkesat teknike të projektit. Materialet në vepër përdoren vetëm për miratimin e mbikëqyrësit të punimeve. Materialet e ardhura, si dhe pajisjet e siguruara nga sipërmarrësi, por që nuk pranohen nga mbikëqyrësi, zëvendësohen me të tjera, me shpenzimet e sipërmarrësit. Në këto raste (si për materialet, ashtu dhe për pajisjet) mospranimi duhet dokumentuar me procesverbalet e analizave të provave, së bashku me aktin teknik, ku të argumentohen shmangiet e palejuara, referuar standardeve të detyrueshme shqiptare ose atyre europiane.

Sa më sipër këto kritere janë qartësisht në kundërshtim me LPP dhe VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar si dhe legjislacionin e ndërtimit Ligji nr.8402 datë 10.09.1998 Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit, Udhëzimit Nr.3 datë 15.02.2001 Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit.

Sa më sipër kërkojmë modifikimin e kriterëve të DST.

II.3. Me shkresën nr.943 prot datë 27.07.2018, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit ku ka vendosur mospranimin e ankesës.

II.4. Në datën 03.08.2018 pala ankimuese “B-93” shpk., ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankesë drejtuar autoritetit kontraktor.

II.5. Njëpërmjet shkresës nr.998 prot., datë 10.08.2018 protokolluar me tonën me nr.1356/2 datë 13.08.2018 me objekt “Dërgohet informacion”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “B-93” shpk për modifikimin e kriterit “Kriteri i vendosur nga Njësia e Prokurimit për kategorinë NS 9-C Punime strukturore speciale tejkalon natyrën dhe vlerën e kontartës objekt prokurimi. Sipas kategorizimit të punimeve të ndërtimit për kategorinë NS9-C duhet që vlera e punimeve që klasifikohen në strukturore speciale të jetë 51-100 milion lekë. Vlera e gjithë objektit është 83,333,021 lekë pra i gjithë objekti është kategoria C. Duke shqyrtuar preventivin e punimeve zërat e tij konsistojnë në punime të zakonshme betoni dhe nuk ka zëra që të legjitimojnë kategorinë C që është vendosur. Kjo kategori licence nuk është në përpjestim dhe e lidhur me aftësitë zabtuese natyrën dhe vlerën e kontratës për këtë arsye kërkojmë modifikimin e kësaj kategorie të licencës. Është NS-9C të bëhet NS-9A”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 12 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 2.3.3/2 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

*Liçensa profesionale e shoqërisë lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:*

- N.P-1-C
- N.P-4- A
- N.P-5- B
- N.P-7- C
- N.P-12-A
- N.S-8- B
- **N.S-9- C**
- N.S-10- A
- N.S-16- A
- N.S-18- A
- N.S-20- A



*Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës .*

III.1.2. Në nenin 46, pika 1, të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” parashikohet shprehimisht se: *"Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese."*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-se përcakohet se: *"Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit."*

III.1.3. Referuar VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 26 “Kontratat për punë publike”, pika 5 përcaktohet: *“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

III.1.4. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26, pika 8, parashikohet si më poshtë:  
*Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:*

*a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*

*b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*

*c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratë”*

III.1.5. Në Lidhjen 4 “Klasifikimi paraprak i shoqërive ndërtimore sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi” të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” , i ndryshuar, parashikohet:

<b>NIVELI I SHOQËRISË</b>	<b>SIPAS VLERAVE NË LËKË TË PUNIMEVE TE KRYERA PËR CDO KATEGORI PUNIMI</b>
<b>A (edhe për herë të parë)</b>	<b>0-20 milion lekë</b>

<i>B</i>	<i>21-50 milion lekë</i>
<i>C</i>	<i>51-100 milion lekë</i>
<i>D</i>	<i>101-200 milion lekë</i>
<i>E</i>	<i>201-400 milion lekë</i>
<i>F</i>	<i>401-800 milion lekë</i>
<i>G</i>	<i>mbi 800 milion lekë</i>

III.1.6. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit zotërojnë kapacitetin teknik e konkretisht Licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve.

Referuar bazës ligjore të sipërcituar kategoria e punimeve N.S- 9 Punime strukturore special: *Konsiderohet ndërtimi i objektit i destinuar për transmetim ngarkese të realizuar në terrene jo të përshtatshme për mbajtjen e këtyre ngarkesave, të objekteve të destinuara për t'u ndërtuar në terrene rezistonte dhe jo të deformueshme, por me parashikime të lëvizjeve gjeologjike, të objekteve me karakter antisizmik të strukturave ekzistuese. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar zbatimin e pilotëve të çfarëdolloj tipi, të themeleve nëntokësore me pilotë ose me mure mbajtëse, me ankorim, të objekteve që duhet të rivlerësohen nga funksioni statik i strukturës, me zbatim të punimeve nëntokësore me mjete speciale, përshirë edhe marrjen e kampioneve për analiza laboratorit nga pikëpamja gjeoteknike, gjithashtu të provave me ngarkesë, të sondave të veprave që sigurojnë qëndrueshmërinë e shpateve. Impermeabilizzazione dhe konsolidimin e terreneve.*

III.1.7. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor, ky i fundit sqaron se “[...] Pretendimet e ankimesit se këto zëra punimesh sipas kategorisë të licencës NS9C nuk janë mbi 51 milion nuk qëndron pasi ligjvënësi ka përcaktuar kategoritë e licencës bazuar në fondin limit total dhe jo mbi bazën e fondit limit të zërave të përvecëm të punimeve.

III.1.8. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se përsa i takon nivelit të klasifikimit të punimeve sipas vlerave në lekë të punimeve të kryera për çdo kategori punimi kjo lidhet ngushtë me punimet që do të kryhen referuar preventivit ku janë përcaktuar zërat konkrete të punimeve, kjo referuar vlerës së përlllogaritur të objektit të kontratës. Megjithëse vlera e kontratës (fondi limit) e përlllogaritur nga autoriteti kontraktor për procedurën e mësipërme të prokurimit është 83,333,021 lekë (pa TVSH), nga preventivi i punimeve rezulton se jo e gjithë shuma në fjalë do të përdoret për punime strukturore speciale.

Sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor, se operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin licensën profesionale të shoqërisë duke dëshmuar se zotërojnë klasifikimin C për kategorinë e licencës NS9 nuk përputhet me vlerën e punimeve të objektit të kontratës si dhe preventivit ku janë përcaktuar zërat konkrete të punimeve. Në këtë kontekst autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin e vendosur, për kategoritë e licencës N.S.9-C, duke ndryshuar nivelin e klasifikimit të licencës.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “B-93” shpk për modifikimin e kriterit “Së dyti: Në pikën 2.2/3 Për kapacitetin teknik pika 4 kriteret e vecanta të kualifikimit, të DST-ve është përcaktuar:

*Një punësim mesatar i të paktën 150 (njqindepesdhjet) personave, për periudhën Janar 2017 – Maj 2018 të vërtetuar me;*

*a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; per periudhen Janar 2017 - Maj 2018.*

*b. List pagesat e punonjesve sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen Janar 2017 - Maj 2018 shoqëruar me formularet e deklarimit te pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetesore.*

*Në DT punimet për këtë objekt janë parashikuar për një periudhë 4 muaj dhe bazuar në manualin e cmimeve të ndërtimit në fuqi Vendim i KM Nr.629 datë 15.07.2015 Për miratimin e manualeve teknike të cmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre kemi bërë zbërthimin dhe analizimin e gjithë zërave të punimeve dhe rezulton që këto punime kryhen me një staf më të reduktuar se ai që ju keni përcaktuar për të njëjtën periudhë kohe. Numri i punonjësve i kërkuar prej jush (150 punonjës) i tejkalon standartet e vendosura nga KM me disa herë. Kërkojmë të ulet numri i punonjësve nga 150 në 80”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.2.1. Në shtojcën 12 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 2.3.3/4 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

*4. Një punësim mesatar i të paktën 150 (njqindepesdhjet) personave, për periudhën Janar 2017 – Maj 2018 të vërtetuar me;*

*a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; per periudhen Janar 2017 - Maj 2018.*

*b. List pagesat e punonjesve sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen Janar 2017 - Maj 2018 shoqëruar me formularet e deklarimit te pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetesore.*

III.2.2. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në

*procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.” ) b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... .”

III.2.3. Referuar Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se “Kontratat për punë publike” janë kontratat publike, që kanë objekt realizimin, projektimin dhe realizimin e punimeve apo të punës ose realizimin me çfarëdo mjeti të një pune, që përputhet me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

III.2.4. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26, pika 8, parashikohet si më poshtë:  
*Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:*

*a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*

*b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*

*c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratë”*

III.2.5. Në interpretim literal të bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni vlerëson se kriteret e kualifikimit duhet të jenë në përputhje me objektin e prokurimit, natyrën, aftësinë zbatuese, vlerën si dhe përmasat/volumin e kontratës. Referuar kriterit për vërtetimin e disponimit nëpërmjet listpagesave të 150 punonjësve, Komisioni vlerëson se autoriteti kontraktor ka tejkalar natyrën dhe përmasat e kontratës pasi një numër i tillë punonjësish është i ekzagjeruar dhe joproportional me objektin e prokurimit. Për autoritetin kontraktor e rëndësishme të provohet disponimi i punonjësve por kjo duhet të përcaktohet në mënyrë të arsyeshme duke pasur parasysh elementë të tillë si natyra e kontratës dhe volumi, afati i saj. Komisioni vlerëson se kriteri i sipërcituar nuk është hartuar tërësisht në përputhje me frymën e legjislacionit të prokurimit publik pasi ka kufizuar konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë duke përfshirë në të vetëm ata operatorë të cilët plotësojnë numrin e kërkuar prej 150 punonjësish duke përjashtuar kështu operatorë të tjerë ekonomikë të cilët edhe pse mund të garantojnë punë të ngjashme me objektin si dhe mund të përmbushin të gjitha kriteret kualifikuese për këtë procedurë prokurimi do të penalizohen vetëm për faktin se nuk

përbushin numrin e kërkuar të punonjësve e cila në rastin konkret është i tepruar.

Në këtë kuptim Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin sa më sipër duke përcaktuar një numër të arsyeshëm dhe proporcional me volumin e punimeve të nevojshme që do të kryhen për realizimin e kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 1 pika 2 të LPP i cili parashikon shprehimisht se:

2. Qëllimi i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Për autoritetin kontraktor është e nevojshme dhe e mjaftueshme që operatorët ekonomikë të plotësojnë të gjitha kapacitetet ekonomike, teknike, profesionale për realizimin me sukses të kontratës duke evituar kushte kufizuese, pasi një kriter i tillë krijon efektin e kufizimit për pjesëmarrjen e gjërë të operatorëve ekonomikë.

Dokumentat e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin sa më sipër duke përcaktuar një numër të arsyeshëm dhe proporcional me volumin e punimeve të nevojshme që do të kryhen për realizimin e kontratës.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron pjesërisht.

III. 3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “B-93” shpk për modifikimin e kriterit “Së treti: Ne pikën 2.2.3 Për Kapacitetin teknik pika 9 Kriteret e Vecanta të Kualifikimit të DST është përcaktuar: Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë ISO 9001-2008 (e vlefshme). Çertifikatë ISO 14001-2004 (e vlefshme). Çertifikatë OHSAS 18001-2007 (e vlefshme). Çertifikatë ISO 39001 -2012 (e vlefshme). Çertifikatë PASS 99-2012 (e vlefshme). Çertifikatë ISO 50001 -2011 (e vlefshme). Çertifikatë ISO 27001:2013 (e vlefshme); Çertifikatë ISO 3834-2:2006 (e vlefshme); Çertifikatë SA 8000:2014 (e vlefshme); Çertifikatë SA 28000:2007 (e vlefshme); Çertifikatë DS CEN/TR 15128:2005 (e vlefshme); Çertifikatë DS CEN/TR 1452-1:2009 (e vlefshme). (Ne rast bashkimi operatorësh ekonomik certifikatat e mesiperme duhet të plotësohen nga të gjithë antarët sipas përqindjes së punimeve që do të marre persiper të realizojë sipas akt marrveshjes).

Certifikata DS CEN/TR 15128:2005 (e vlefshme) është një certifikatë për “Shqyrtimin i Standarteve Europiane për riparimin e sistemeve të kanalizimeve dhe kullimit. Objekti i prokurimit janë punimet për rikonstruksionin e rrjetit të ujësjellësit (furnizim me ujë) nuk ka punime kanalizimi (të ujrave të bardha apo të zeza) apo punime kullimi të ujrave. Kërkesa për paraqitjen e kësaj certifikate është e pambështetur teknikisht , është kufizuese për operatorët ekonomikë dhe e pabazuar në ligj.

Certifikata DS CEN/TR 1452-1:2009(e vlefshme) është për Sistemet e tubacioneve plastike për furnizimin me ujë dhe kullimin e ujrave të zeza mbi tokë nën presion. Në lidhje me vendosjen e kësaj certifikate si kriter vlerësimi është e pambështetur teknikisht, kufizuese për OE dhe e pabazuar në ligj. Nëse shikojmë projektin e zbatimit do të vërejmë që tubacionet në asnjë segment të tij nuk janë mbi tokë por nën tokë. Rrjedhimisht ky kriter është abuziv pasi nuk ka lidhje me objektin e prokurimit.

Për sa më sipër kërkojmë verifikimin e standarteve të certifikatave certifikatë DS CEN/TR 15128:2005 dhe DS CEN/TR 1452-1:2009 dhe heqjen e tyre si kriter vlerësues”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Në shtojcën 12 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 2.3.3/9 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

Çertifikatë ISO 9001-2008 (e vlefshme).

Çertifikatë ISO 14001-2004 (e vlefshme).

Çertifikatë OHSAS 18001-2007(e vlefshme).

Çertifikatë ISO 39001 -2012 (e vlefshme).

Çertifikatë PASS 99-2012 (e vlefshme).

Çertifikatë ISO 50001 -2011 (e vlefshme).

Çertifikatë ISO 27001:2013 (e vlefshme)

Çertifikatë ISO 3834-2:2006 (e vlefshme)

Çertifikatë SA 8000:2014 (e vlefshme)

Çertifikatë SA 28000:2007 (e vlefshme)

Çertifikatë DS CEN/TR 15128:2005 (e vlefshme)

Certifikatë DS CEN/TR 1452-1:2009(e vlefshme)

(Ne rast bashkimi operatorësh ekonomik certifikatat e mesiperme duhet te plotesohen nga te gjithë antaret sipas perqindjes se punimeve qe do te marre persiper te realizoje sipas akt marrveshjes)

III.3.2. Në nenin 46, pika 1 e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “ [...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e

*prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese [...]*”

Në nenin 46 pika 2 e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : *“[...] Autoriteti kontraktor mund të kërkojë edhe certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit.[...]”*

III.3.3. Në nenin 30 “Kërkesat e Cilësisë” të VKM Nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik” i ndryshuar parashikohet se:

*“1. Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.”* Çertifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

III.3.4. Neni 1 i LPP parashikon shprehimish se *“Qëllimi i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik si dhe dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

III.3.5. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, vërehet se, autoriteti kontraktor ndër të tjera ka kërkuar edhe paraqitjen e dy certifikatave, konkretisht certifikatat Çertifikatë DS CEN/TR 15128:2005 (e vlefshme) dhe Certifikatë DS CEN/TR 1452-1:2009(e vlefshme. Komisioni i Prokurimit Publik, me qëllim verifikimin dhe marrjen e një informacioni sa më të saktë në lidhje me këto standartizime, iu drejtua institucionit të Drejtorisë e Përgjithshme të Standartizimit, i cili është institucion publik i njohur në nivel evropian e ndërkombëtar si organi kombëtar i standardizimit në Republikën e Shqipërisë në shërbim të ekonomisë dhe të të gjitha palëve të interesuara, duke u siguruar atyre standardet e të gjitha fushave. Nga korrespondenca me këtë institucion, ky i fundit në lidhje me dy standartizimet e mësipërme informon se, përsa i përket standartit DS CEN/TR 15128:2005 është standart për “Shqyrtimine Standardeve Europiane për riparimin e sitemeve të kanalizimeve dhe kullimit”, standart i cili është i shfuqizuar, pra nuk është në fuqi dhe nuk është zëvendësuar me standard/dokument tjetër.

Ndërsa për sa i përket standartit tjetër DS CEN/TR 1452-1:2009, të kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi nga verifikimet e kryera

rezulton se ka të bëjë me sistemet e tubacioneve plastike për drenazhimin/kullimin pa presion nën tokë dhe sistemin e kanalizimit të ujrave të zeza pa presion. KPP gjykon se ky standart është në përputhje me objektin e prokurimit, nuk është diskrimnues dhe nuk tejkalon natyrën e kontratës e cila në rastin konkret parashikon në preventiv kryerjen e punimeve nën tokë në përputhje me këtë standart.

III.3.6. Referuar kërkesave të autoritetit kontraktor, pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, si dhe nga korrespondenca me institucionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Standartizimit, KPP, gjykon se standarti DS CEN/TR 15128:2005 në kushtet kur është i shfuqizuar dhe nuk është zëvendësuar me një standart të ri, duhet hequr nga dokumentat e tenderit. Ndërkohë për sa i përket, standartit tjetër, DS CEN/TR 1452-1:2009, i cili ka të bëjë me sistemet e tubacioneve plastike për drenazhimin/kullimin pa presion nën tokë dhe sistemin e kanalizimit të ujrave të zeza pa presion, KPP referuar preventivit të punimeve objekt prokurimi, gjykon se kjo kërkesë e autoritetit kontraktor është në përputhje me objektin e prokurimit e rrjedhimisht nuk duhet të hiqet nga kriteret kualifikuese.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht dhe autoriteti kontraktor duhet të kryejë modifikimet përkatëse sipas konstatimeve të mësipërme.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “B-93” shpk për modifikimin e kriterit “Së katërti: Në pikën 2.2/3 Për kapacitetin teknik pika 12 Kriteret e vecanta të Kualifikimit të DST është përcaktuar:

*12. Operatori ekonomik duhet të ketë nje kontrate me nje laborator te certifikuar me certifikate ISO 9001:2008 cilesie, certifikate ISO 14001certifikate OHSAS 18001per mjedisin per kryerjen e analizave te betoneve, dherave dhe rerave qe do te perdoren ne objekt i cili te jete i akredituar per kryerjen e analizave sipas standarteve shteterore si me poshte:*

- - *Percaktimi i rezistences ndaj copezimit SSH EN 1097-2:2010 S SH EN 932-1:2004 2*
- - *Beton i ngurtesuar : Mostrat e marra nga struktura – Marrja ekzaminimi dhe testimi ne shtypje <2000KN SSHEN 12504-1:2009 SSHEN 12504-1:2009 2*
- - *Metodikat e kryerjes se provave pa shkaterrim te betonit- Përcaktimi i shpejtësisë së impulsit ultrasonik ( Sshen 12504-4:2008 1*
- - *Beton i fresket ; Përberja e perzierjes se betonit / formula e mix design SSHEN 206:2013 + A 1:2016*
- - *; Percaktimi i forces ne shtypje e mostrave te testimit <2000 kN SSHEN 12390-3:2009 / AC :2011*
- - *Percaktimi i pikes se zbutjes S SH EN 1427:2015*
- - *Percaktimi i trashesise se nje shtrese bituminoze – mm S SH EN 12697 – 29 : 2006, S SH EN 12697 – 36:2006 S SH EN 12697 – 27 : 2022 2*
- - *Prova e penetrometrit SPT – S SH EN ISO 22476-3:2005/A1 : 2011 1*
- - *Hekur per punIme ndertimi; Rezistenca ne terheqje – S SH EN 6892-1:2016*
- - *Dhera – Percaktimi i permbajtjes se ujit % Iso/TS 17892-1:2014*
- - *Percaktimi i peshes specifike. Metoda me piknometer ISO/TS 17892-3:2015*



- - Mteriale rrugore – Metodikat e kryerjes se provave pa shkaterrim te shtresave rrugore . Metoda e testimit per percaktimin e deformimeve me pajisjen Falling-Ëeight-Type Impulse Load Device – >I um ASTM D 4694-2015 1
- - Karakteristikat e siperfaqes se rruges dhe te pistes se avionit, Metodrat e proves, Matja e profilit te terthorte dhe gjatesore te ashpersise dhe devijimet ne drejtim te valezimeve gjatesore. Llogaritja e indeksit nderkombetare te rrjeshmerise se rrugesve- S SH EN 13036-6:2008 ASTM E 950/E 950M:2009 ASTM E 1926:2015 1

Kriteri i vendosur nga Njësia e Prokurimit për paraqitjen e një kontarte me një laborator të certifikuar me certifikatë ISO 9001:2008 cilësie, 14001: 18001 për kryerjen e analizave të betoneve, dherave dhe rërave është e ekzagjeruar duke qenë se me lidhjen e kontratës cdo kontraktor e ka detyrimin ligjor që të bëjë analiza laboratorike për punimet e kryera . Por këto analiza bëhen pasi merret paraprakisht miratimi i mbikqyrësit të punimeve për realizimin e një punimi të caktuar. Kjo kërkesë është e parakohshme dhe diskriminuese. Paraqitja e kësaj kontrate nuk ndikon drejtpërdrejt në vlerësimin e aftësisë teknike të OE pjesmarrës pasi kjo është një pikë që ezaurohet në fazën e zbatimit të punimeve.

Sa më sipër ky kriteri është tërësisht në kundërshtim me legjislacionin specifik të ndërtimit dhe duhet të hiqet”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.4.1. Në shtojcën 12 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 2.3.3/9 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

12. Operatori ekonomik duhet të kete nje kontrate me nje laborator te certifikuar me certifikate ISO 9001:2008 cilesie, , certifikate ISO 14001certifikate OHSAS 18001 per mjedisin per kryerjen e analizave te betoneve, dherave dhe rerave qe do te perdoren ne objekt i cili te jete i akredituar per kryerjen e analizave sipas standarteve shteterore si me poshte:

- Percaktimi i rezistences ndaj copezimit SSH EN 1097-2:2010 S SH EN 932-1:2004 2
- Beton i ngurtesuar : Mostrat e marra nga struktura – Marrja ekzaminimi dhe testimi ne shtypje <2000KN SSHEN 12504-1:2009 SSHEN 12504-1:2009 2
- Metodikat e kryerjes se provave pa shkaterrim te betonit- Përcaktimi i shpejtësisë së impulsit ultrasonik ( Sshen 12504-4:2008 1
- Beton i fresket ; Përberja e perzierjes se betonit / formula e mix design SSHEN 206:2013 + A 1:2016
- ; Percaktimi i forces ne shtypje e mostrave te testimit <2000 kN SSHEN 12390-3:2009 / AC :2011
- Percaktimi i pikes se zbutjes S SH EN 1427:2015
- Percaktimi i trashesise se nje shtrese bituminoze – mm S SH EN 12697 – 29 : 2006, S SH EN 12697 – 36:2006 S SH EN 12697 – 27 : 2022 2
- Prova e penetrometrit SPT – S SH EN ISO 22476-3:2005/A1 : 2011 1
- Hekur per punime ndertimi; Rezistenca ne terheqje – S SH EN 6892-1:2016
- Dhera – Percaktimi i permbajtjes se ujit % Iso/TS 17892-1:2014
- Percaktimi i peshes specifike. Metoda me piknometre ISO/TS 17892-3:2015

- Mteriale rrugore – Metodikat e kryerjes se provave pa shkaterrim te shtresave rrugore . Metoda e testimit per percaktimin e deformimeve me pajisjen Falling-Ëeight-Type Impulse Load Device –>I um ASTM D 4694:2015 1

- Karakteristikat e sipërfaqes se rruges dhe te pistes se avionit, Metodatat e proves, Matja e profilit te terthorte dhe gjatesore te ashpersise dhe devijimet ne drejtim te valezimeve gjatesore. Llogaritja e indeksit nderkombetare te rrjeshmerise se rrugesve- S SH EN 13036-6:2008 ASTM E 950/E 950M:2009 ASTM E 1926:2015 1

III.4.2. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... .”

III.4.3. Referuar Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se “Kontratat për punë publike” janë kontratat publike, që kanë objekt realizimin, projektimin dhe realizimin e punimeve apo të punës ose realizimin me çfarëdo mjeti të një pune, që përputhet me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

III.4.4. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26, pika 8, parashikohet si më poshtë:  
Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratë”

III.4.5. Referuar sa më sipër KPP gjykon se kërkesa e autoritetit kontraktor për dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të një kontrate me nje laborator te akredituar per kryerjen e analizave te betoneve, dherave dhe rerave qe do te perdoren ne objekt, në vetvete nuk është një kriter diskriminues dhe i pamundur për tu përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesmarrës. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Në rastin konkret KPP gjykon se është në të drejtën e autoritetit të kërkojë garanci lidhur me cilësinë e materialeve që do të përdoren për realizimin e objektit.

Ndërsa sa i takon kërkesës së autoritetit kontraktor që laboratorit të jetë i certifikuar me certifikatat ISO 9001:2008 cilesie, , certifikate ISO 14001certifikate OHSAS 18001 si dhe pjesës së dytë të kriterit që laboratorit të kryerjë një sërë analizash si më sipër cituar, janë të ekzagjeruara dhe kufizojnë pjesmarrjen e operatorëve ekonomikë në këtë procedurë. Më konkretisht KPP gjykon se përcaktimi i autoritetit kontraktor per kryerjen e analizave sipas standarteve shteterore si me poshte:

- *Percaktimi i rezistences ndaj copezimit SSH EN 1097-2:2010 S SH EN 932-1:2004 2*
- *Beton i ngurtesuar : Mostrat e marra nga struktura – Marrja ekzaminimi dhe testimi ne shtypje <2000KN SSHEN 12504-1:2009 SSHEN 12504-1:2009 2*
- *Metodikat e kryerjes se provave pa shkaterrim te betonit- Përcaktimi i shpejtësisë së impulsit ultrasonik ( Sshen 12504-4:2008 1*
- *Beton i fresket ; Përberja e perzierjes se betonit / formula e mix design SSHEN 206:2013 + A 1:2016*
- *; Percaktimi i forces ne shtypje e mostrave te testimit <2000 kN SSHEN 12390-3:2009 / AC :2011*
- *Percaktimi i pikes se zbutjes S SH EN 1427:2015*
- Percaktimi i trashesise se nje shtrese bituminoze – mm S SH EN 12697 – 29 : 2006, S SH EN 12697 – 36:2006 S SH EN 12697 – 27 : 2022 2*
- *Prova e penetrometrit SPT – S SH EN ISO 22476-3:2005/A1 : 2011 1*
- *Hekur per punime ndertimi; Rezistenca ne terheqje – S SH EN 6892-1:2016*
- Dhera – Percaktimi i permbajtjes se ujit % Iso/TS 17892-1:2014*
- *Percaktimi i peshes specifike. Metoda me piknometer ISO/TS 17892-3:2015*
- *Mteriale rrugore – Metodikat e kryerjes se provave pa shkaterrim te shtresave rrugore . Metoda e testimit per percaktimin e deformimeve me pajisjen Falling-Ëeight-Type Impulse Load Device – >I um ASTM D 4694-2015 1*
- *Karakteristikat e sipërfaqes se rruges dhe te pistes se avionit, Metododat e proves, Matja e profilit te terthorte dhe gjatesore te ashpersise dhe devijimet ne drejtim te valezimeve gjatesore. Llogaritja e indeksit nderkombetare te rrjeshmerise se rrugesve- S SH EN 13036-6:2008 ASTM E 950/E 950M:2009 ASTM E 1926:20151”, është i ekzagjeruar, joproportional dhe mund të përbëjë shkak për skualifikim të padrejtë të operatorëve ekonomikë në fazën e vlerësimit të ofertave, nëse ky laborator mund të mos përmbushë qoftë edhe për një nga elementët e sipërcituar. Akoma më tej KPP gjykon se është e vështirë të përcaktohet një dokument konkret i cili do të provojë që laboratorit është i specializuar për të gjitha këto kërkesa. Në këtë kuptim KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e kriterit duke kërkuar nga operatorët ekonomikë vetëm një kontratë me një laborator të specializuar/akredituar për kryerjen e analizave, betoneve dhe dherave dhe duke hequr nga kriteri të gjithë elementët e tjerë pasi janë të tepruara dhe diskriminuese dhe nuk respektojnë testin e proporcionalitetit në këtë fazë të procedurës.*

Sa më sipër pretendimi i ankimesit qëndron pjesërisht.

III.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “B-93” shpk për modifikimin e kriterit “Së pesti: Gjithashtu edhe kërkesat: **Tuba HDPE 100**

- Autorizimin nga prodhuesit për distributorin e autorizuar
- Autorizimin nga distributori për ofertuesin
- Çertifikatë për prodhuesin/ distributorin ISO ISO 9001 , ISO 14001 , PAS 1075 ,
- Standardi DIN 8074
- Miratimet PAS 1075 , DIN 8075 , DVGË GË 335 A2 , EN 12201
- Certifikatat e testimit
- Testet e miratimit të materialit në përputhje me PAS 1031 dhe PAS 1075
- Testet e sigurimit të cilësisë së materialit në përputhje me PAS 1075
- Testet e miratimit të tubave në përputhje me PAS 1075
- Testet e kontrollit të cilësisë së tubave në përputhje me PAS 1075

**Kërkesat**

Shënimi i tubave me shenja lazer duke përfshirë gjurmimin e tipit barkod të tipit 128-C në përputhje me ISO 12176-4 të shtypur direkt në tub.

**Pajisje elektrofuzioni për nyje e tubave PE 100**

- Autorizimin nga prodhuesit për distributorin e autorizuar
  - Autorizimin nga distributori për ofertuesin
  - Çertifikatë për prodhuesin/ distributorin ISO ISO 9001 , ISO 14001
  - Miratimet DVGË , EN 12201
  - Kërkesat
- Materiali: PE 100  
Vlerësimi i presionit: SDR 11

Kompensimi i temperaturës (koha e fuzionit përshtatet automatikisht me temperaturën e ambientit)

Barkodi për procesin e shkrirjes automatike

**Saracinesca sipas dimensioneve te preventivit**

- Autorizimin nga prodhuesit për distributorin e autorizuar
  - Autorizimin nga distributori për ofertuesin
  - Çertifikatë për prodhuesin/ distributorin ISO ISO 9001
  - Standardi EN 1074 (1-2) , ISO 5996
  - Certifikuar për ujë të pijshëm për DVGË
  - Kërkesat
- Përmasat ballë për ballë në EN 558-1: 2017 seri F14 (DIN 3202, F4)  
Dimensionet e fllanxhave dhe shpimet e EN 1092-2  
Trupi dhe mbulesa e hekurit EN 1563  
Epoxy veshura brenda dhe jashtë DIN 30677-2 dhe GSK "mbrojtje korrozioni të rëndë"

(trashësia e veshjes > 250µm)

Projektuar për temperatura të shërbimit nga 0 ° C (duke përjashtuar acar) deri në 40 °

C

### **Ajrues**

- Autorizimin nga prodhuesit për distributorin e autorizuar
- Autorizimin nga distributori për ofertuesin
- **Çertifikatë për prodhuesin/ distributorin ISO ISO 9001**
- Standardi EN 1074-4
- Certifikuar për ujë të pijshëm për DVGÜ
- Kërkesat
  - Valvul automatik me ajër të dyfishtë
  - Fllanxa EN1092-2
  - Rondele gome EPDM
  - Shkarkimi i vëllimeve të mëdha të ajrit gjatë fillimit dhe zbrazjes së tubacioneve
  - Shkarkimi i vëllimeve të vogla të ajrit ndërsa tubacionet janë nën presion
  - Veshje epoxy të brendshme dhe të jashtme

### **Mates uji sipas dimensioneve të preventivit**

- Autorizimin nga prodhuesit për distributorin e autorizuar
- Autorizimin nga distributori për ofertuesin
- **Çertifikatë për prodhuesin/ distributorin ISO ISO 9001 ISO 14001**
- Standardi EN 1074-4, ISO 4064 , EN 14154 OIML R49
- Certifikuar për ujë të pijshëm (p.sh: ACS ose ERAS) Miratimi i MID

Duhet të hiqen pasi kërkesat për paraqitjen e pajisjeve dhe materialeve janë të pavend. Listën dhe cilësinë e materialeve që vendosen në vepër nuk mund ta testojë KVO. Referuar Udhëzimit Nr.3 datë 15.01.2001 “Për Mbikqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit në pikën 9 të tij shprehet qartazi se: 9. Materialet që vijnë në kantier duhet të jenë në përputhje me kërkesat teknike të projektit. Materialet në vepër përdoren vetëm për miratimin e mbikëqyrësit të punimeve. Materialet e ardhura, si dhe pajisjet e siguruara nga sipërmarrësi, por që nuk pranohen nga mbikëqyrësi, zëvendësohen me të tjera, me shpenzimet e sipërmarrësit. Në këto raste (si për materialet, ashtu dhe për pajisjet) mospranimi duhet dokumentuar me procesverbalet e analizave të provave, së bashku me aktin teknik, ku të argumentohen shmangiet e palejuara, referuar standardeve të detyrueshme shqiptare ose atyre europiane”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.5.1. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... .”*

III.5.2. Referuar Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se *“Kontratat për punë publike” janë kontratat publike, që kanë objekt realizimin, projektimin dhe realizimin e punimeve apo të punës ose realizimin me çfarëdo mjeti të një pune, që përputhet me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor.*

III.5.3. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26, pika 8, parashikohet si më poshtë:  
*Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:*

*a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*

*b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*

*c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratë”*

III.5.4. Nga shqyrtimi i preventivit të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi KPP konstaton se një pjesë të rëndësishme zënë zërat për furnizim vendosje të pajisjeve të tilla si tuba rakorderi, matësa uji, saracineska etj. Në këtë kuadër KPP gjykon se autoriteti kontraktor me të drejtë ka kërkuar të paraqiten nga operatorët ekonomikë dokumentat si autorizim prodhuesi apo distributori për këto pajisje. KPP gjykon se kërkesa e autoritetit kontraktor për paraqitjen e këtyre dokumentave është në përputhje me objektin e prokurimit, nuk është diskriminuese dhe nuk i shërben uljes së konkurrencës por i shërben autoritetit kontraktor për krijimin e bindjes mbi origjinën e pajisjeve e që do të përdoren në këtë vepër. Megjithatë KPP gjykon se edhe në kriterin e sipërcituar autoriteti duhet të heqë elementët e tjerë të kërkuar që kanë të bëjnë me certifikat e prodhuesit/distributorit si dhe specifikimet teknike të pajisjeve (dimensionet, përmasat, temperatuarat, trashësia, veshja) që janë elementë që nuk i përkasin kësaj faze të procedurës por një fazë të mëvonshme asaj të zbatimit të kontratës dhe lëvrimit të mallit. Në këtë kuptim KPP gjykon se në kriterin sa më sipër autoriteti kontraktor duhet të kërkojë që për pajisjet e parashikuara në preventiv që do të vendosen në vepër operatorët ekonomikë të paraqesin autorizim prodhuesi ose distributori por duhet të heqë nga kriteri të gjithë elementët e tjerë si certifikatat e prodhuesit si dhe specifikimet teknike të pajisjeve që në këtë fazë të procedurës janë të tepruara dhe mbingarkojnë së tepërmi operatorët ekonomikë.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron pjesërisht.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

### **Vendos**

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “B-93” sh.p.k për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr. REF-79689-07-18-2018 me objekt: “*Rikonstruktion i rrjetit të ujësjellësit Memaliaj, rrjet shpërndarës*” me fond limit 83,333,021 lekë pa tvsh, e parashikuar për tu zhvilluar në datën 20.08.2018, nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Tepelenë.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në dokumentat e tenderit sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “B-93” shpk.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**Nr. 1356 Protokolli, Datë 03.08.2018**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**